



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.530/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Abedin Bajraktari, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur, më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 25.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Hudhet i palejuar apeli** A.nr 530/2021, i datës 24.02.2021, i parashtruar nga Abedin Bajraktari, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

### A r s y e t i m

Me datë 24.02.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Abedin Bajraktari të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 05 shkurt 2021, me të cilin thekson se me datë 18.01.2021 ka aplikuar me email për regjistrim për votim jashtë vendit, i njëjti po ashtu thekson se në të njëjtën ditë ka pranuar email automatik nga KQZ për pranimin e emailit të tij për aplikim, gjithashtu pretendon se me datë 15.02.2021 ka pranuar një email nga KQZ para se të dërgoj emailin për aplikim dhe pastaj kur tenton ta konfirmoj abonimin nuk i lejohet.

Paneli pasi qe shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

#### **Apeli është e palejuar**

Paneli, pasi qe konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-së, me të cilën ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se ne rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së, me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesi i apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
- b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
- c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
- d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe
- f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është e palejuar, nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 530/2021 më datën 25.02.2021

**Kryesuese e Panelit**

Milena Đerić



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.